



Tiranë më 01.09.2022

VENDIM
Nr.20, Datë 01.09.2022

Bazuar në nenin 21 të ligjit 40/2016 "Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë" dhe nenin 19, të Rregullores së Gjykimit Disiplinor e Profesional në datë 08.04.2022, u thirr Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë nga Presidentja e Urdhrit të Psikologut, për shqyrtimin e ankesës me:

Palë Ankuese: Znj.Elsa Kera

Drejtuar: Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut

Objekti: Shfuqizimi i Vendimit Nr.5 datë 05.07.2022 të Komisionit Etik e Gjykimit Disiplinor Profesional

Baza Ligjore: Ligji 40/2016 "Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë", Kodi i Etikës dhe Deontologjisë të Psikologëve në Republikën e Shqipërisë, Rregullorja e Gjykimit Profesional

Rrethanat e çështjes

Në datë 10.05.2022 ka mbërritur pranë zyrës së Urdhrit të Psikologut një ankesë drejtuar Znj.Elsa Kera, nga ana e Z.Dritan Nikshiqi. Ankesa drejtohej nga Z.Dritan Nikshiqi, i cila pretendon se në kryerjen e raportit psikologjik nga psikologjia Znj.Elsa Kera, e cila është caktuar si eksperte psikologe nga Gjykata e Shkodrës si eksperte psikologe në çështjen gjyqësore familjare me objekt: Ndryshim i kushteve të ushtrimit të përgjegjësisë prindëror, gjatë ushtrimit të detyrës së saj ka shkelur standardet dhe parimet e Kodit Etik e Deontologjik të Psikologut.

Seanca dëgjimore

Në seancën dëgjimore të zhvilluar nga Komisioni i Etikës dhe Gjykimit Disiplinor në datë 02.09.2022 ishin të pranishëm të dyja palët . Ata u dëgjuan nga anëtarët e Komisionit Etik e Gjykimit Disiplinor Profesional, lidhur me qëndrimin e tyre sa i përket kësaj çështje. Nuk pati asnjë provë shtesë të depozituar nga asnjëra prej palëve. Të dyja palët patën kohën e nevojshme të shprehnin argumentat e tyre e më pas t'i përgjigjeshin pyetjeve të anëtarëve të Komisionit Etik e Gjykimit Disiplinor Profesional lidhur me çështjen.



Vendimi i Komisionit Etik e Gjykimit Disiplinor Profesional

Pasi dëgjoi të dyja palët gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore dhe shqyrtoi të gjithë dokumentacionin e paraqitur prej tyre, Komisioni Etik i Gjykimit Disiplinor Profesional vlerësoi se:

1. Komisioni Etik dhe Gjykimit Disiplinor Profesional pranon ankesën e Z. Dritan Nikshqi si të arsyeshme dhe të mbështetur në Kodin e Etikës dhe Deontologjisë të Psikologëve në Republikën e Shqipërisë (Qershor, 2017).
2. Konstatohet shkelje nga psikologia Znj. Elsa Kera të standardit 2.01, pika b “Kufijtë e Kompetencës” të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë të Psikologëve në Republikën e Shqipërisë Psikologia ka kryer procesin e vlerësimit dhe intervistën me fëmijën në një ambient banimi, ndërkohë që duhet të kishte marrë masa të siguronte një ambient më të përshtatshëm për procesin dhe moshën e fëmijës.
3. Konstatohet shkelje nga psikologia Znj. Elsa Kera të standardit 3.04, “Shmangia e Dëmtimit” të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë të Psikologëve në Republikën e Shqipërisë. Në kushtet ku transferimi i fëmijës nga babai tek nëna do të rezultojë në stres të shtuar psikologjik për fëmijën që refuzon të takojë nënën, psikologia nuk ka rekomanduar masat e duhura për të shmangur ose minimizuar dëmtimin e fëmijës në këtë proces.
4. Konstatohet shkelje nga psikologia Znj. Elsa Kera të standardit 9.10, “Shpjegimi i rezultateve të vlerësimit” të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë të Psikologëve në Republikën e Shqipërisë. Psikologia ka përdorur teste psikometrike gjatë procesit të vlerësimit, pikëzimi dhe interpretimi i të cilave nuk është përfshirë në akt ekspertimin e punuar për Gjykatën dhe nuk i është shpjeguar palëve apo përfaqësuesve.

Pasi shqyrtoi çështjen, dëgjoi të dyja palët si dhe mblodhi të gjitha provat e vëna në dispozicion nga palët, në përfundim, Bazuar në ligjin 40/2016 “Për urdhrin e psikologut në Republikën e Shqipërisë”, Neni 20, pika 1(a), neni 12 pika 1 (a), Komisioni Etik i Gjykimit Disiplinor Profesional me anë të Vendimit Nr.3, datë 26.05.2022 vendosi:

1. Pranimin e ankesës Z.Dritan Nikshiqi si të arsyeshme dhe të mbështetur në Kodin e Etikës dhe Deontologjisë të Psikologëve në Republikën e Shqipërisë .
2. Konstatimin e shkeljes nga psikologia Znj. Lala të standardit 2.01 “Kufijnjtë e Kompetencës”, pika (b) të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë të Psikologëve në Republikën e Shqipërisë; të standardit 3.04 “Shmangia e Dëmtimit të Kodit Etik e Deontologjik; shkelje e standardit 9.10 “Shpjegimi i rezultateve të vlerësimit” të Kodit Etik e Deontologjik.
3. Të japë masën disiplinore për psikologjen Znj.Elsa Kera: “Përfshirje nga Urdhri i Psikologut për një periudhë 1 (një) mujore”.



Pasi u njoh me këtë vendim psikologia Znj.Elsa Kera, duke mos qenë dakord me vendimin Nr.5, datë 05.07.2022 të Komisionit të Etikës e Gjyimit Disiplinor Profesional. bazuar në nenin 21 të Ligjit Nr.40/2016 “Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”, në datë 29.07.2022, depozitoi pranë zyrës së Urdhrit të Psikologut një ankesë drejtuar Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut, me objekt shfuqizimin e Vendimit Nr.5, datë 05.07.2022 të Komisionit Etik e Gjyimit Disiplinor Profesional, duke ushtruar në këtë mënyrë të drejtën e ankimit pranë Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut, brenda afatit ligjor.

Ankesa e psikologes Znj.Elsa Kera drejtuar Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut

Znj.Elsa Kera, në ankesën drejtuar Këshillit Kombëtar në mënyrë të përmbledhur argumenton se:

- Asnjë nga shkeljet e konstatuara nga Komisioni Etik i Gjyimit Disiplinor profesional, në Vendimin Nr.5 datë 05.07.2022 nuk qëndron.
- **Znj.Kera ka marrë të gjitha masat e nevojshme dhe të arsyeshme që takimi dhe vlerësimi të realizohej në përputhje me standardet e kërkuara në pikë 2.01/b,** konkretisht takimi është zhvilluar në një ambient të llojit apartament të marrë me qira për të ushtruar profesionin në mënyrë të përkohshëm, i vënë në funksion nga ankuesja **vetëm për qëllime të këtij vlerësimi që është realizuar në qytetin e Shkodrës,** duke e konsideruar të përshtatshëm dhe në përputhje me standardet e kërkuara. Si përfundim takimi është zhvilluar:
 1. Në ambient të përshtatshëm për ushtrimin e profesionit;
 2. Vendi siguronte privatësinë;
 3. Vendi garantonte ruajtjen e konfidencialitetit;
 4. Vendi ishte në përputhje me llojin e profilit të shërbimit të ofruar.
- Lidhur me shkeljen e Standardit 3.04 “Shmangia e dëmtimit” ankuesja pretendon se ky përfundim i vendimit të Komisionit paraqet disa problematika thelbësore përmbajtësore dhe procedurale. **Së pari,** shqyrtimi i këtij aspekti të procedurës së vlerësimit psikologjik objekt ankimi, është jashtë objektit të ankesës së paraqitur nga Z.Nikshiqi. Kjo ka sjellë si rezultat pamundësinë e ankueses për të dhënë argumente ezauruese për këto pretendime. **Së dyti,** ekspertja vlerësimin objekt gjykimi e ka kryer në kuadër të një procesi gjyqësor me detyra shumë specifike të caktuara nga gjyqtarja e çështjes përkatëse. Detyra të cilat miratohen me vendim të ndërmjetëm të gjykatës.
- **Nga analiza e detyrave të lëna nga gjykata për rastin në fjalë, nuk evidentohet asnjë kërkesë drejtuar ekspertit lidhur me parashikimin e mundshëm të rrethanës së ndryshimit të kujdestarisë së fëmijës dhe të masave më të përshtatshme për të zbutur ndikime të mundshme.**



- Lidhur me pretendimin për shkeljen e standardit për shmangien e dëmtimit, duhet të evidentohet dhe një fakt thelbësor që është anashkaluar tërësisht nga Komisioni i Etikës së Gjyimit Disiplinor Profesional: ***vlerësimi psikologjik i realizuar nga ekspertja nuk kishte marrë formën përfundimtare dhe nuk ishte administruar si provë nga gjykata.*** Kjo fazë e procesit gjyqësor u pamundësua pikërisht nga kërkesa për pushim e bërë nga Z.Nikshiqi (në formën e mosparaqitjes në gjykim, fakt që u pohuar prej vetë tij si në formularin e ankesës, ashtu edhe gjatë seancës dëgjimore përpara Komisionit). Pra referuar dispozitave procedurale, përse kohë gjykata nuk e kishte administruar si provë aktin e ekspertimit, ***ai nuk konsiderohet i formës përfundimtare***, si i tillë, asnjë nga palët e pranishme në proces, madje as ekspertja dhe aq më tepër Komisioni, nuk mund të hamendësojë se cila do të ishte forma e tij përfundimtare, çfarë elementesh, shpjegimesht apo parashikimesh të tjera do të kishte ai.
- Në lidhje me shkeljen e standardit 9.10 “Shpjegimi i rezultateve të vlerësimit”, Znj.Kera shprehet se gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, nuk kishte asnjë informacion lidhur me pretendimet për shkeljen e këtij standardi, duke qenë në këtë mënyrë e pamundur për një mbrojtje efektive gjatë seancës dëgjimore.
- Në aktin e ekspertimit të depozituar në gjykatë, ekspertja ka përshkruar me detaje të gjithë procedurën e kryerjes së vlerësimit dhe të hartimit të aktit, ka përshkruar metodologjinë, duke listuar të gjitha metodat dhe burimet e informacionit, ka listuar kufizimet përkatëse, si dhe ka bërë një përshkrim të detajuar të rrethanave të rastit, të vlerësimit të këtyre rrethanave dhe të konkluzioneve të saj teknike, të mbështetura në argumente shkencore, për të cilat ishte thirrur në fakt nga gjykata.

Ekspertja Znj.Elsa Kera ka listuar edhe cilat kanë qenë instrumentet psikometrike të përdorura për këtë vlerësim, duke listuar:

- Pyetëtori i prindërimit Alabama (APQ, FRICK, 1991)
 - Teste projektive
 - Administrim i testit CORE-OM
 - Inventari i depresionit (BECK)
-
- Vendimi 5/2022, nuk është i mbështetur në prova dhe në një hetim të plotë dhe ezaurues
 - Vendimit 5/2022 i mungon arsyetimi që lidh veprimet e kryera nga ankuesja, provat përkatëse me përfundimet për shkeljet e pretenduara.
 - Masa disiplinore e marrë nuk respekton parimin e proporcionalitetit dhe të përshkallëzimit
 - Shkelja e dispozitave procedurale, pasi Procesverbali i Seancës Dëgjimore është mbajtur nga njëri prej anëtarëve.

Nga sa më sipër, ankuesja Znj.Elsa Kera përfundimisht kërkoi:

1.Pranimin e ankesës.

2.Shfuqizimin e Vendimit Nr.5 datë 05.07.2022 të Komisionit Etik e Gjyimit Disiplinor Profesional.



Vlerësimi i Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut

Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut pasi u njoh me rastin dhe mori në shqyrtim këtë çështje në mbledhjen e datës 02.09.2022 vlerësoi se:

Komisioni Etik i Gjykimit Disiplinor Profesional ka arsyetuar në Vendimin Nr.5, datë 05.07.2022, se psikologia Znj.Elsa Kera në trajtimin e rastit, ku ka qenë e thirrur nga gjykata në cilësinë e ekspertes psikologe, ka shkelur Kodin Etik e Deontologjik të psikologut e më konkretisht standardin **2.01 – Kufijtë e kompetencës, pika (b)**; të standardin 3.04, “Shmangia e Dëmtimit”, si dhe standardin 9.10, “Shpjegimi i rezultateve të vlerësimit” të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë të Psikologëve në Republikën e Shqipërisë. Për këto arsye ka vendosur bazuar në nenin 20, pika 1, gërma (dh), të ligjit nr.40/2016 *‘Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë’* dhe nenit 12, pika 1, gërma (f), të *“Rregullores së Gjykimit Disiplinor Profesional të Urdhrit të Psikologut*, masën disiplinore: **“Përjashtim nga Urdhri i Psikologut për një periudhë 1 (një) mujore”**

Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut, pasi shqyrtoi me kujdes qëndrimet e të dyja palëve të paraqitura në Komisionin Etik e Gjykimit Disiplinor Profesional, ankimin e Znj.Elsa Kera drejtuar Këshillit Kombëtar si dhe argumentimin në Vendimin Nr.5 datë 05.07.2022 të Komisionit Etik e Gjykimit Disiplinor Profesional, vlerëson se:

1.Këshilli Kombëtar i vlerëson si të drejta argumentat e paraqitura nga anëtarët e komisionit Etik e Gjykimit Disiplinor Profesional, në lidhje me konstatimin e shkeljeve të standardeve standardin 2.01 – Kufijtë e kompetencës, pika (b); të standardin 3.04, “Shmangia e Dëmtimit”, si dhe standardin 9.10, “Shpjegimi i rezultateve të vlerësimit” të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë të Psikologëve në Republikën e Shqipërisë.

2.Këshilli Kombëtar i vlerëson të drejta të gjithë arsyetimin e Komisionit Etik e Gjykimit Disiplinor Profesional, në Vendimin Nr.5 datë 07.05.2022:

1. Komisioni Etik dhe Gjykimit Disiplinor Profesional pranon ankesën e Z. Dritan Nikshqi si të arsyeshme dhe të mbështetur në Kodin e Etikës dhe Deontologjisë të Psikologëve në Republikën e Shqipërisë (Qershor, 2017).
2. Konstatohet shkelje nga psikologia Znj. Elsa Kera të standardit 2.01, pika b “Kufijtë e Kompetencës” të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë të Psikologëve në Republikën e Shqipërisë Psikologia ka kryer procesin e vlerësimit dhe intervistën me fëmijën në një ambient banimi, ndërkohë që duhet të kishte marrë masa të siguronte një ambient më të përshtatshëm për procesin dhe moshën e fëmijës.
3. Konstatohet shkelje nga psikologia Znj. Elsa Kera të standardit 3.04, “Shmangia e Dëmtimit” të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë të Psikologëve në Republikën e Shqipërisë. Në kushtet ku transferimi i fëmijës nga babai tek nëna do të rezultojë në stres të shtuar psikologjik për fëmijën që refuzon të takojë nënën, psikologia nuk ka rekomanduar masat e duhura për të shmangur ose minimizuar dëmtimin e fëmijës në këtë proces.



4. Konstatohet shkelje nga psikologia Znj. Elsa Kera të standardit 9.10, "Shpjegimi i rezultateve të vlerësimit" të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë të Psikologëve në Republikën e Shqipërisë. Psikologia ka përdorur teste psikometrike gjatë procesit të vlerësimit, pikëzimi dhe interpretimi i të cilave nuk është përfshirë në akt ekspertimin e punuar për Gjykatën dhe nuk i është shpjeguar palëve apo përfaqësuesve.

PËR KËTO ARSYE,

Këshillit Kombëtar bazuar në nenin 21, pika 2 e Ligjit Nr.40/2016 "Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë",

VENDOSI:

1. Të mos pranojë ankesën e Znj.Elsa Kera drejtuar Këshillit Kombëtar për shfuqizimin e Vendimit Nr.5 datë 07.05.2022 të Komisionit Etik e Gjykimit Disiplinor Profesional.
2. Të lërë në fuqi Vendimin Nr.5 datë 07.05.2022 të Komisionit Etik e Gjykimit Disiplinor për dhënien e masës disiplinore për psikologun Znj.Elsa Kera: "Përgjashtim nga Urdhri i Psikologut për një periudhë 1 (një) mujore".

PRESIDENTI
Dr.Valbona TRESKA



SEKRETARE
Armira BABOÇI



Blv.Gjergj Fishta, Ndërtesa nr.26, Kati II, Ap.9, Tiranë,
email: sekretaria@urdhriipsikologut.al, Tel.: 0035544 51 1804